



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOV**

Numri i lëndës: 2023:169080  
Datë: 05.06.2024  
Numri i dokumentit: 05783998

**K.DH.Shk II.nr. 882/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit NPT “ACOM”, me numër unik identifikues 810348814 dhe me seli në Mitrovicë, rr. ”Ferat Draga”, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Asdren Bytyqi me zyre në Prishtinë, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1238/23 të datës 22.02.2024, me datë 05.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1238/23 të datës 22.02.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1238/23 të datës 22.02.2024, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “Trepça” Sh.A., me seli në Mitrovicë ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 236/2023, i lejuar me datë 28.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 236/2023, i lejuar me datë 28.07.2023, nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1238/23 të datës 22.02.2024.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë,

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NPT "ACOM" me seli në Mitrovicë, rr. "Ferat Draga", me dt. 28.07.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 7/2023, e datës 25.05.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën prej 52,215.00 EUR (me shkronja: pesëdhjetë e dymijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro), me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë me datë 25.06.2023, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore

Po ashtu Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit lejuar urdhri përmbartimor nuk është dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar, ashtu siç parashihet me nenin 40, par. 1, pika 1.3 të LPP-së. Duke qenë se fatura nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, i ka propozuar gjykatës që të hedhë poshtë urdhrin përmbartimor P.nr. 236/2023, të datës 28.07.2023. Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se në prapësimin e debitorit nuk ceket asnjë nga shkaqet për të cilën mund të paraqitet prapësimi, ashtu siç parashihet me nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se fatura i përmban të gjitha elementet që e bëjnë të përshtatshëm për përmbartim, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Fatura me nr. 7/2023, e datës 25.05.2023, i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbartje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbartjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar, nënshkruar dhe protokolluara nga debitori, rrjedhimisht debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga këto fatura.

Po ashtu kjo Gjykate gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga vula e pranimit të shkresave të debitorit e vënë në faturë si dhe nga flete dërgesa për pranimin e mallit nr. 44/2023 e lëshuar nga vet debitori me rastin e pranimit të faturës, e po ashtu fatura i është bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbartimit pasi që është e përshtatshme për përmbartim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej

shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës se parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur ka hedhur prapësimin e debitorit të përmbarimit.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm dhe se ashtu siç ka deklaruar në ankesë debitori kundër urdhrit përmbarimor P.nr. 236/2023, i datë 28.07.2023.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e shkallës së dytë**

**K. DH.Shk II.nr. 882/24 me datë 05.06.2024**

**Gjyqtarja,**

**Saranda Bogaj Sheremeti**